



Republika e Kosovës



Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)-

01.Nr. zyrtar/ 2024

### Procesverbal

**Takimi i VI-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024**

**Më 10.XII.2024**

Në takim prezantuan:

**Besim Ilazi**, Kryetar i Komunës

**Zahir Doda**, DKA

**Jaser Jaha**, Stacioni i Policisë-Kaçanik

**Fidaim Fazliu**-KBI

**Fatmir Qaka**, EVSB

**Bujar Bajra**-Sektori i Emergjencave Civile Komunale

**Elmihane Malsiu**-HANDIKOS

**Naim Hysa**-Kryqi i Kuq Komunal

**Jashar Selimi**-Këshilli i Prindërve

**Ylber Tusha**-Përfajqsues i bizneseve

**Shemsedin Abazi**-KLSP

**Nexhip Jaha**-FSK

**Vedat Dema-Zyra për Barazi Gjinore**

**Fadil Guri-Zyra për Komunitete dhe Kthim**

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës .

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar .
- 2.Gjendja e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve .
- 3.Masat e ndërmarrura për përballjen me sfidat e mundshme gjatë sezonit të dimrit.
- 4.Miratimi i planit të punës së KKSB-së për vitin 2025.
- 5.Raporti mbi rastet e dhunës në familje për kët vit në komunën tonë dhe masat e ndërmarrura për parandalimin e kësaj dukurie .
- 6.Të ndryshme

1-Pika e parë e rendit të ditës miratohet nga të pranishmit .

2-Për gjendjen e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve , Kryetari fjalën ia dha zv.Komandantit të Policisë z.Jaser Jaha .

**Jaser Jaha -Gjendja e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve ka qenë e qetë dhe pa ndonjë rast të veqant që ka prishur rendin dhe sigurinë publike .**

Duhet vevar disa raste e të cilat janë – Lëndime trupore 5 raste , posedim i pa autorizuar i armëve 4 raste , vjedhje 9 raste , vjedhje e rëndë 5 raste , 1 rast e kemi pasur dhunë në familje , dëmtim të pasuris 1 rast , 1 rast i heqjes së instalimit publik ,1 rast ngacmim , shitje dhe shpërndarje të narkotikëve 1 rast , kanosje 8 raste , 1 rast mashtrim , sulm 5 raste , shpërdorim i pasurisë se huaj 1 rast , rrezikim i trafikut publik 1 rast , 10 aksidente trafiku pa lëndime dhe 1 me lëndim të lehtë .

Një rast aksidenti me fatalitet ka ndodhur në rrugën magjistrale Kaçanik – Hani Elezit me çrast ka humbur jetën një vajzë e re ku si shkak ka qenë mospërshtatja e shpejtësisë së automjetit dhe humbja e drejtimit të automjetit .

Sa i përket masave të ndërmarra për sezonin dimërorë ne kemi planin operativ dhe kemi mbajtur një takim me kompanin e kontraktuar të rrugëve dhe me zytrarë Komunal ku ne kemi shfaqur disa shqetësime që i kemi pasur vitin e kaluar dhe po shpresojmë që kët vit kemi për të kaluar më mirë .

Për dukurinë e dhunës në familje ne kemi pasur një rast të raportum .

Ktë muaj e kemi pasur aksionin për sensibilizim me çrast kemi pasur disa aktivitete duke shpërndarë fletushka të cilat janë bërë nga ekipi i sektorit por edhe përmes pikave të kontrollit .

Jemi duke punuar me orarë 12 orësh për shkakë se kemi të angazhuar zyrtarë Policorë ne veri të vendit .

**Vedat Dema** – U raportua për një rast të dhunës në familje dhe a kishe mundur të na tregosh më në detaje .

**Jaser Jaha** – Rasti nuk ka qenë edhe aq i rëndë por që si rast është përcjell tek organet e drejtësisë .

**Kryetari** – Kemi pika të veçanta sa i përket dhunës në familje dhe mirëmbajtjes së rrugëve kështu që nuk kemi nevojë të diskutojm në kët pikë .

### **3.Masat e ndërmarrura për përballjen me sfidat e mundshme gjatë sezonit të dimrit.**

**Bujar Bajra** – Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë me kohë ka punuar për zbatimin e planit operativ dhe me kohë ka kontraktuar kompanin për mirëmbajtjen e rrugëve .

Kjo sezonë mundë të sjellë edhe vërvshime dhe ne kemi intervenuar në disa fshatra përfundimtarët përfundimtarët .

**Jaser Jaha** – Mendoj se mekanizmat për intervenim në ndonjë rast duhet të kenë një komunikim të kordinuar .

Ne si Polici ku duhet të drejtohem i ndonjë problemi që shfaqet në teren sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve .

**Kryetari** – Komunikimi duhet të egzistoj me të gjithë mekanizmat por që adresa e parë është menagjeri i kompanisë .

Qytetarët duhet të dijnë se në rast bllokimit të rrugëve prioritet u ipet atyre rrugëve që të shpien në drejtim të Institucioneve përfundimtarët që ju mundësuar atyre kryerjen e shërbimeve por edhe zhbllokimin e rrugëve të vendeve rurale .

**Fadil Guri** – Po mendoj që me disa veprime që po ndërmirren nga institucionet po i bëjm parazit qytetarët .

Duhet që ti sfidojm të ndermarrin veticinitativë në tejkalim të një situate që është emergjente .

Paisjet dimërore përfundimtarët jo ti ken me vete po ti vendosin .

### **4.Miratimi i Planit të Punës së KKSB – së përfundit 2025**

-Plani i punës së KKSB u miratua nga të pranishmit .

### **5.Raporti mbi rastet e dhunës në familje përfundimtarët 2025**

Të pranishëm në kët takim ishin edhe dy zyrtare nga Enti përfundimtarët KKSB dhe Mirëqenëje Sociale dhe Kryetari fjalën ua dha këtyre dy zyrtareve .

**Antigona Baftiaj** – Nga janari i vitit 2024 deri më tanë në Qendrën përfundimtarët KKSB Sociale janë referuar gjithsej 21 raste .

Gjatë këtij viti vetëm një rast e kemi pasur në strehimore , 8 raste urdhër mbrojtje ku prej tyre 3 raste janë pasive dhe 5 janë aktive .

Rastet e dhunës në familje janë të ndryshme dhe dallon rasti prej rastit .

Egziston hallka zingjirore për trajtimin e rasteve dhe bashkpunimi i mekanizmave është i mirë .

**Fikrije Bunjaku –**Kjo dukuri është shqetësuese edhe në Komunën tonë dhe ne punojmë edhe në vetëdijsim për paraçitje të rastit .

Kësaj dhune ju ekspozohen më së shumti gratë .

Roli ynë është këshillues por që nuk mjafton vetëm këshilla ngase dhunuesit në shumicën e rasteve janë recidivista dhe organet e drejtësisë duhet të reagojnë me kohë.

Edhe strehimoret nuk janë një zgjidhje e përhershme ngase pas një kohe viktima prapë kthehet te dhunuesi i cili nuk ka marrë denim meritorë.

Në kahasim me vitin e kaluar numri i rasteve të dhunës në familje ka rënë ku nga 26 sa ishin më 2024 sivjet kemi 21 raste .

**Kryetari –** Uroj që mos të kemi raste të dhunës në familje por që Drejtësia të reagoj me kohë sidomos për personat që janë recidivistë .

Ne si Komunë kemi një marrëveshje me strhimoren regionale por që jam kundër disa zërave që kërkojnë ndërtimin e strehimoreve nëpër Komuna .

Strehimoret kanë kosto dhe janë të papërballueshme për Komunat por që nuk është ide e mirë që këto strehimore të ndërtohen nëpër Komuna .

**Fikrije Bunjaku –**Për të luftuar këtë dukuri duhet të funksionoj trekëndëshi Enti Social , Policia dhe Gjykata .

**Vedat Dema –**Komuna jonë ka edhe mekanizmin kundër dhunës në familje duke i përfshirë gjithë akterët . Shfrytëzoj rastin të falenderoj edhe Bashkësinë Islame e cila nëpër Xhami ka shpërnda mesazhin kundër dhunës në familje ,gjithashtu falenderoj edhe Drejtorinë e Arsimit për bashkëpunim në mbajtjen e ligjëratave nëpër shkolla .

Ne si mekanizëm kemi qenë të përfshirë në fushatën për parandalimin e dhunës në familje .

Sa i përket çështjes së strehimoreve për viktimat edhe unë pajtohem me Kryetarin që kjo çështje duhet të i takoj nivelit qendrorë ngase ka kosto .

**Fidaim Fazliu –**Më intereson të dijë sa prej 21 rasteve që janë raportuar, sa prej dhunuesve kanë marr denim meritorë .

Sa prej rasteve janë personalitetë publike që kanë ushtruar dhunë .

Është për keqardhje që disa media feminzmin janë duke e keqëpërdorë duke e stërmadhuar kët çështje .

Mendoj se fushata e sensibilizimit të qytetarëve ndaj kësaj dukurie duhet të jetë për gjatë tërë vitit.

Ne me mekanizmat që i kemi mbrenda Bashkësisë Islame gjithmonë do të jemi në shërbim të luftimit të çdo dukurie që cenon sigurinë e qytetarëve .

**Fikrije Bunjaku** – Shumica e rasteve janë për shkaqe të përdorimit të rrjeteve sociale dhe mos menagjimi i duhur i këtyre rrjeteve nga palët e konfrontuara .

**Vedat Dema** – Mekanizmi për parandalimin e dhunës në familje egziston në Komunën tonë ku janë të përfshirë të gjithë akterët .

Unë si kordinator i këtij mekanizmi kam thirrur disa takime por që Gjykata nuk ka marrë pjesë në këto takime .

Ndoshta është mirë që herave tjera kur të diskutohet kjo temë ftesa të ju bëhet nga zyra e Kryetarit .

**Jaser Jaha** - Qdo rast të dhunës në familje ne në kompetencat tona i trajtojmë në mënyrën më të mirë të mundëshme .

Për raste të tillë ne i njoftojmë të gjithë akterët, më pas lënda dorëzohet në Prokurori .

Për secilin rast ne si Polici i kemi dosjet me të gjitha argumentet e nxjerrura gjatë procedurës .

Kujdesë të veçant ne i kushtojmë personave që kanë një urdhërmbranjte .

**Kryetari** - Po besoj se herave tjera në takime të tillë të ftohen edhe mekanizma tjere që janë jasht KKSB – së .

#### REKOMANDIMET

- 1.Tolerancë zero ndaj atyre që nuk respektojnë ligjin në komunikacion .
- 2.Më shumë aktivitete vëtdijsuese në parandalimin e dhunës në familje .
- 3.Një kordinim më i mirë i trekëndëshit Polici , Enti për Punë Sociale , Gjykatë për parandalimin e dhunës në familje .
- 4.Të vetëdijsohen qytetarët për marrjen e veticinitativës në raste emergjente .

Kryesoi z. Besim Ilazi = Kryetarë



Procesmbajtës Fatmir Qaka